



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2023:267437  
Datë: 10.01.2024  
Numri i dokumentit: 05173072

**AA.nr.01/2024**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktit administrativ sipas padisë së paditëses - propozueses V... B... nga Prizreni, kundër të paditurës Universiteti Ukshin Hoti me seli në Prizren, me bazë juridike anulim i vendimit me propozim për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Administrative, A.nr.2117/2023, të datës 15.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 05.01.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e paditëses - propozueses V... B...nga Prizreni, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2117/2023, i datës 15.12.2023, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2117/2023, të datës 15.12.2023, është hedhë poshtë si e pa rregullt padia/propozimi i paditëses V.... B... nga Prizreni e ushtruar me datë 05.12.2023 e evidentuar me numër A. nr.2117/2023.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditëses av.Muharrem Kurtaj, nga Prishtina për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa e paditëses/propozueses, si e bazuar. Ndërsa, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative A.Nr.2117/2023 i datës15.12.2023 të prishët duke e konsideruar të rregullt

padinë/propozimin apo të njëjtën ta kthej në rigjykim ose ta ndryshoj aktvendimin e ankimuar, duke e aprovuar në tersi propozimin e propozueses për caktimin e masës së sigurimit- shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundër propozuesit Nr.01-734 të datës 20.11.2023 deri në vendimin përfundimtar të gjykatës përkitazi me padinë e rregullt të paditëses.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pretendimet ankimore, pas vlerësimit të aktvendimit të ankimuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

### **Ankesa është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja/propozuesja ka ushtruar padi në gjykatën e shkallës së parë me datën 05.12.2023 me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet Propozimi i Propozueses si i bazuar dhe të anulohet vendimi / shtyhet ekzekutimi i vendimit Nr.01-734 i datës 20.11.2023 të paditurës, Universiteti i Prishtinës “Ukshin Hoti” Prizren-Senati Universiteti i Prishtinës, deri në vendimin përfundimtar të gjykatës përkitazi me padinë e paditëses.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e përgatitjes së shqyrtimit të çështjes, pas shqyrtimit paraprak të padisë/propozimit për masë të përkohshme, ka gjetur se padia dhe propozimi për masë i paditëses është jo i plotë, jo i rregullt, andaj gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e datës 05.12.2023, e ka obliguar paditësen që në afatin prej 8 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, ta plotësojë padinë duke bërë rregullimin e padisë në aspektin subjektiv dhe atë objektiv, ashtu që të përcaktojë saktë të paditurin pasi që në procedurën e konfliktit administrativ vlerësohet ligjshmëria e vendimit përfundimtarë të organit të administratës dhe palë në procedurë duhet të jetë pala e cila edhe e ka nxjerrë vendimin kontestues, andaj obligohet paditësi që gjykatës së shkallës së parë ti precizojë saktë se kush është palë e paditur në këtë procedurë respektivisht cili organ (institucion) i administratës së Republikës së Kosovës dhe cilin vendim kërkon ta anuloj si dhe gjykatës së shkallës së parë t’ia dorëzoj të gjitha provat me të cilat i dëshmon se i njëjti i ka shteruar mjetet juridike në procedurë administrative para se t’i drejtohet gjykatës me këtë padi, pasi që e njëjta nuk e përcakton saktë vendimin përfundimtar në procedurën administrative ,të cilin kërkon ta anulojë/shtyjë ekzekutimin e vendimit.

Paditësja me datë 12.12.2023, në gjykatën e shkallës së parë ka dorëzuar parashtrësën për rregullimin e padisë/propozimin për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, ku ka kërkuara nga gjykata anulimin me kërkesë për shtyrje e ekzekutimit të vendimit Nr.01-734 të datës 20.11.2023 të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren-Senati i Universitetit nga e cila shihet qartë se e njëjta nuk i ka evituar të metat e padisë ashtu siç është kërkuar në kuptim të dispozitave të LKA-së. Andaj, gjykata e shkallës së parë e ka hedhë poshtë padinë e paditësit në këtë çështje juridike administrative si të pa rregullt në kuptim të dispozitës së nenit 33.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, me të cilin përcaktohet se: *“Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do*

*ta hedh poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm”.*

Kolegji i kësaj gjykate e vlerëson të drejtë këtë qëndrim juridik të dhënë në aktvendimin e ankimuar, pasi që paditësja në rastin konkret nuk i kanë evituar të metat e padisë. Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është marrë duke respektuar dispozitat ligjore dhe procedurale, vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, si dhe me zbatim të drejtë të së drejtës materiale. Sepse në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur që të vazhdoi më tutje me procedimin e kësaj çështje, dhe në kuptim të nenit 33.2 të LKA-së, me të drejtë e ka hedh poshtë padinë e paditëses si të parregullt.

Sa i përket pretendimeve ankimore se aktvendimi i atakuar është me arsyetim të mangët ligjor dhe faktik, i njëjti përmban shkelje të rënda të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) të LPK-së ngase aktvendimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzekutohet. Ngase gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar ka shqyrtuar duke e thelluar në çështjen meritore, me çrast edhe e ka hudhur poshtë padinë. Aktin administrativ e ka nxjerr organi më i lartë ndaj të cilit vendim përfundimtar kemi dorëzuar padinë në gjykatë në kuptim të nenit 13 par. 2, paditësja-propozuesja ka kërkuar anulimin/shtyrjen e ekzekutimit të vendimit Nr. 01-734 të datës 20.11.2023 të nxjerr në emër të Senatit të Universitetit nga kryesuesi i Senatit. Nuk është kontestuese se paditësja-propozuesja vijon studimet tek e paditura, ndërsa me mos vazhdimin e regjistrimit të vitit të dytë do ti sjell dëm të pariparueshëm ngase e njëjta ngec një vite mbrapa me studime, e njëjta dëshmon se ka përmbushur kriterin prej 70 % të provimeve të kaluara gjithsej 7 provime nga 10 sa ka viti i parë i studimeve, andaj caktimi i masës së sigurisë i kërkuar nga propozuesja është masë e domosdoshme dhe ligjore e që janë përmbushur në mënyrë komulative kriteret e përcaktuara me nenin 22 par.2 të LKA-së.

Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoj, ngase të njëjtat janë të pa bazuara, për tu aprovuar ankesa. Sepse me nenin 13 të LKA-së, përcaktohet se: *“Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë. 2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar.”* Po ashtu, me nenin 14 të LKA-së, përcaktohet se: *“Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj”.* Kurse me nenin 29 të LKA-së, përcaktohet se: *“1. Nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejshëm prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t’i është refuzuar ankesa. 2. Në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni mund të veprojë pala edhe kur sipas kërkesës së saj nuk është nxjerrë vendimi nga organi i shkallës së parë, kundër aktit të cilit nuk mund të bëhet ankesa. 3. Nëse organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit mund të bëhet ankesa, nuk ka nxjerrë asnjë vendim në bazë të kërkesës brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh ose në një afat më të shkurtër të paraparë me dispozita të veçanta, pala ka të drejtë t’i drejtohet me kërkesë organit të shkallës së dytë. Kundër vendimit të organit të shkallës së dytë, pala mund të*

*fillojë konfliktin administrativ, por mundet, nën kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni, ta fillojë edhe nëse ky organ nuk ka nxjerrë vendim".* Ndërsa nga shkresat e lëndës shihet qartë se paditësja-prpozuesja nuk ka argumentuar me prova konkrete se e njëjta ka shterur mjetet juridike, ashtu siç kërkohet me dispozitën ligjore të lartcekur nga neni 29 të LKA-së. Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditëses u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, kolegji vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 209 pika b) të LPK-së dhe neni 63 të LKA-së për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

AA.nr.01/2024, me dt.05.01.2024

**Kryetari i kolegjit**  
Ramiz Kuqi